



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit
SJ-044
Prishtinë, më 20 shtator 2018

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 20 SHTATOR 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme sipas kërkesës së 53 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në fillim, kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka propozuar që rendi i ditës i kësaj seance të plotësohet edhe me tri pika shtesë:

- 1) Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane Investime për Projektin e Autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë - Zahaq,
- 2) Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës lidhur me Programin Mbështetës për Ujësjetllës dhe Kanalizim në Zonat Rurale – Faza VI, dhe
- 3) Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës.

Po ashtu, edhe Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi ka propozuar plotësimin e rendit të ditës të kësaj seance edhe me një pikë.

Kryetar i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Ismajl Kurteshi e paraqiti dhe e arsyetoi propozimin për plotësimin e rendit të ditës me këtë pikë: Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin Evropa kreative për mbështetjen e sektorëve kulturorë dhe kreativ.

Lidhur me propozimet e lartshënuara diskutuan deputetët: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së, Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së, Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP të Nisma Socialdemokrate, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari i hodhi në votim propozimet e lartshënuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 74,
Kundër -----15,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash vendosi që rendi i ditës i kësaj seance të plotësohet edhe me katër (4) pika, sipas propozimeve të lartshënuara, si dhe shqyrtimi dhe miratimi i tyre të bëhet me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Në vazhdim, kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës si në vijim:

1. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-090 për ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për pikat e rendit të ditës 1, 2 dhe 3 kanë përfunduar në seancat e mëparshme të sesionit pranveror, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Andaj, në këtë seancë u procedua vetëm me votimin e tyre.

Më pas, kryetari e hodhi në votim amendamentin e vetëm të propozuar në këtë Projektligj.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi amendamentin e propozuar nga Komisioni funksional.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentin e miratuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 96,
Kundër -----0,
Abstenime ----- 8.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-090 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2017, pjesa e parë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

2. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-094 për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në programin “Evropa për qytetarët”

Kryetari i hodhi në votim amendamentin 1 dhe 2, të propozuar nga komisioni funksional.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi amendamentet 1 e 2 të propozuara nga Komisioni Funksional.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 96,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 7.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-094 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin “Evropa për qytetarët”.

3. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-095 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS +” Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport

Kryetari e hodhi në votim projektligjin.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 97,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-095 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Komisionit Evropian dhe Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në “ERASMUS +” Programin e Unionit për Arsim, Trajnim, Rini dhe Sport.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-099 për aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA)

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 06/L-099 për aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA) dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ministri i Administratës Publike, Mahir Jagcilar, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e Projektligjit. Në fund, ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji.

Lidhur me Projektligjin nr. 06/L-099 për aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA), diskutuan deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Milaim Zeka, në emër të GP të Nisma Socialdemokrate, Vjosa Osmani-Sadriu, Driton Selmanaj, dhe kryeministri Ramush Haradinaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në vazhdim, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi amendamentet 1 e 2 të propozuara nga Komisioni funksional.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 78,
Kundër ----- 13,
Abstenime ----- 4.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk e miratoi Projektligjin nr. 06/L-099 për aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për Themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA).

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime, për projektin e Autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa, e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 06/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime, për projektin e Autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 89,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 3.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-098 për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Investime, për projektin e Autostradës Prishtinë-Pejë, segmenti Kijevë-Zahaq.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 89,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-112 për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, lidhur me Programin Mbështetës për Ujësjiellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale – Faza VI

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim amendamentin 1 të propozuar në këtë Projektligj.

Kuvendi me shumicë votash e miratoi amendamentin 1 të propozuar nga Komisioni funksional.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentin e miratuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 90,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-106 për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës, lidhur me Programin Mbështetës për Ujësjiellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale – Faza VI.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin Evropa kreative për mbështetjen e sektorëve kulturorë dhe kreativ

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi e ka shqyrtuar Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin Evropa kreative për mbështetjen e sektorëve kulturorë dhe kreativ dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 93,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-102 për ratifikimin e Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin Evropa kreative për mbështetjen e sektorëve kulturorë dhe kreativ.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së jashtëzakonshme në orën 15:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale